

V E N D I M
" NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata e Rrethit gjyqesor Tirane me trup gjykues te perbere prej:

KREYTARE SÉANCE :ZEGJINE SOLLAKU
GJYQTARE :ALTINA XHOXHA
GJYQTARE :ENKELA BAJO

Asistuar nga sekretare gjyqesore Daniela Ruca,sot me dt 24.05.2001,mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen civile me nr 2465 Akti qe I perket paleve ndergjygjese:

P A D I T E S:Minstria e Bujqesise dhe Ushqimit,me cilesine e ortakut shteteror ne Shoqerine "S.SARANDA"sh.p.k,perfaqesuar me autorizim nr 1408 Prot dt 21.04.2000 nga Yllka Terihati dhe Florian Xhafa.

I PADITUR:Vasil Iatru,dtl 1947,lindur ne Grazhdan sarande dhe banues ne Sh.B.A,New York, 5955 Delafield AVE Riverdaille,gjykuar ne mungese me shpallje .

O B J E K T I:Prishjen e shoqerise "S.SARANDA"sh.p.k,Sarande.

BAZA LIGJORE:Neni 153,154,157 K.Pr.Civile dhe neni 264 I Ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Gjykata si shqyrtoi çeshtjen ne teresi,administroi provat shkresore,degjoi pretendimet e paditesit ne séance gjyqesore,qe se fundi kerkoj :pranimin e padise,I padituri ne mungese me shpallje mujore,

V E R E N

Se paditesi Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit eshte drejtuar gjykates me nje padi me objekt prishjen e shoqerise "S.Saranda"sh.p.k. ne te cilen eshte dhe ortak me te paditurin Vasil Iatru

Sikurse rezultoi ne séance gjyqesore nga provat e paraqitura dhe shpjegimet e paditesit,shoqeria "S.Saranda "sh.p.k eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr 7037 dt 11.10.1994 te Gjykates se Rrethit





PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te nenit 306,309,310 te K.Pr.Civile

VENDOSI

Pranimin e kerkese -padise.
Prishjen e shoqerise "S.SARANDA"sh.p.k.
Emertimin e kesaj shoqerie "Shoqeri ne likujdim e siper".
Caktimin si likujdator te shoqerise z.Fatos Mulla.
Shpenzimet gjyqesore siç jane bere.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne gjykatën e Apelit
Tirane,brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e shpalljes se
vendimit,per te paditurin ne mungese ky afat fillon pas shpalljes.
U shpall ne Tirane , sot me dt 24.05.2001.

**SEKRETARE
DANIELA RUCA**

**GJYQTARE
ZEGJINE SOLLAKU**

SHPENZIMET GJYQESORE	
KERKESE PADIA	1.500 LEKE
<hr/>	
TOTALI	1.500 LEKE



Vertetohet se ky vendim ka marre forme te prere me dt 08.06.2001 per paditesen dhe me dt 24.06 .2001 per te paditurin ne mungese,me shpallje njemujore.
Tirane me dt 17.09.2001

**K/ SEKRETARE
FLUTURA KADIU**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E LARTE
KOLEGJI CIVIL**

Nr. 2807 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 1339 i Vendimit

**V E N D I M
NE EMER TE REPUBLIKES**

Kolegji Civil i Gjykeses se Larte i perbere nga:

Thimjo KONDI	Kryesues
Nikoleta KITA	Anetar
Agron A.LAMAJ	-
Valentina KONDILI	-
Irma BALA	-

ne seancen gjyqesore te dates 10.07.2003 mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe u perket:

PADITES: Ministria e Ekonomise, *ne mungese.*

I PADITUR: Vasil Jatru, *perfaqesuar nga av.Anastas Duro.*

Avokati i shtetit Abaz Deda, bashkuar me paditesin, ne mungese.

OBJEKTI I PADISE: *Prishje e shoqerise "Saranda", sh.p.k. Sarande.*



Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane, me vendimin e saj date 06.12.2002 ka vendosur:

- *Pranimin e kerkese padise.*
- *Prishjen e shoqerise "Saranda" sh.p.k.. Emertimin e kesaj shoqerie shoqeri ne likujdim e siper.*
- *Caktimi si likujdatore te shoqerise z.Mimoza Sulai.*

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr. 816, date 22.04.2003 ka vendosur:

- *Prishjen e vendimit nr.4832, date 06.12.2002 te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane e nxjerrjen e ceshtjes jashte juridiksionit gjyqesor.*

Kunder ketij vendimi ka ushtruar rekurs avokati i shtetit duke parashtruar si me poshte:

- *Vendimi i gjykates se apelit vjen ne kundershtrim te hapur me ligjin dhe me provat e administruara gjate gjykimit.*
- *Gjykata e apelit ka vepruar ne kundershtrim me nenin 37 te statutit te shoqerise.*
- *Kjo pike e Statutit gjen mbeshtetje ligjore ne nenin 264 te ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".*
- *Gjykata e apelit ka dale jashte juridiksionit gjyqesor te kesaj ceshtje duke shkelur haptazi nenin 3 te ligjit nr.8017 date 25.10.1995 "Per procedurat e falimentimit".*
- *Gjykata e apelit i eshte referuar nenit 39 te Statutit i cili ka te beje me konfliktet qe lindin ne zbatim te statutit dhe te kontrates se shoqerise ne momentin e fillimit. Ne nuk kemi konflikt per sa i perket zbatimit te statutit dhe kontrates se lidhur por eshte se nuk ka ekzistuar ne asnje moment kjo shoqeri.*
- *Ne keto kushte kerkojme prishjen e vendimit te gjykates se apelit dhe lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se shkalles se pare.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATES SE LARTE

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Thimjo KONDI, perfaqesuesin e te paditurit qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se apelit, dhe pasi diskutoi ceshtjen ne teresi,



VEREN:

Vendimi nr.816, date 22.04.2003 i gjykates se apelit Tirane, me te cilin eshte prishur vendimi nr.4832 date 06.12.2002 i gjykates se rrethit gjyqesor Tirane dhe eshte nxjerre ceshtja jashte juridiksionit gjyqesor, eshte i bazuar ne ligj.

Ne pikepamje procedurale ky vendim duhet te ndryshohet per t'u pershtatur zgjidhja e dhene me formulimin e nenit 466, pika "c", te K.Procedures Civile. Kur gjykata e apelit prish vendimin e gjykates se shkalles se pare per mungese te juridiksionit gjyqesor, krahas kesaj duhet te shprehet edhe per pushimin e gjykimit te ceshtjes, konform dispozites se mesiperme, sepse mungesa e juridiksionit gjyqesor nenkupton mungesen e shqyrtimit te saj ne themel prej gjykates.

Gjykata e shkalles se pare ka vendosur prishjen e shoqerise S.Saranda - sh.p.k., percaktimin e saj si shoqeri ne likujdim e siper dhe caktimin e likujdatorit, duke i u referuar nenit 264 te Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "*Per shoqerite tregtare*".

Gjykata ka pranuar rregjistrimin e shoqerise S.Saranda - sh.p.k., si joint venture midis dy ortakeve, pales paditese, qe perfaqeson kapitalin shteteror shqiptar ne masen 30 perqind, dhe te paditurit si ortak i huaj qe zoteron 70 perqind te kapitalit.

Gjykata ne vendimin e saj pranon se kjo shoqeri nuk ka funksionuar qe ne krijimin e saj, nuk eshte derdhur gjithe kapitali nga i padituri, si dhe nuk jane likujduar prej saj detyrimet fiskale.

Pretendimit se konflikti midis ortakeve nuk eshte ne juridiksionin e gjykatave shqiptare, gjykata e shkalles se pare i eshte pergjigjur negativisht, duke arsyetuar se neni 37 i statutit te shoqerise ka perparesi ndaj nenit 39 te tij, sepse e para eshte dispozite e vecante, ndersa e dyta dispozite e pergjitheshme.

Ndersa gjykata e apelit, duke i u referuar nenit 8 te ligjit nr.7764, date 02.11.1993 "*Per investimet e huaja*" dhe nenit 39 te statutit te shoqerise, ka arritur ne perfundimin qe zgjidhja e konfliktit midis ortakeve nuk eshte ne juridiksionin e gjykatave shqiptare, por ne juridiksionin e arbitrazhit nderkombetare te pranuar paraprakisht me marrveshje te paleve.



Perfundimi i mesiperm i gjykates se apelit eshte ligjerisht i bazuar dhe pretendimet e ngritura ne rekurs per prishjen e tij nuk gjejne mbeshtetje ne ligj.

Pala e paditur, perfaqesuar nga Avokati i Shtetit, ka pretenduar se gjykata e apelit ka vepruar ne kundersizim me nenin 37 te statutit te shoqerise. Ky pretendim eshte i gabuar, sepse nuk bazohet e kuptimin dhe permbajtjen e kesaj dispozite te Statutit, te interpretuar ne harmoni me dispozitat pasuese, nenet 37, 38 dhe 39 te tij.

Neni 37 i statutit parashikon pushimin e veprimtarise se shoqerise ne vitin 2023, ose me perpara, sipas propozimeve te bera nga nje prej ortakeve, kur ne nje periudhe prej dy vitesh shoqeria eshte jo rentabel, ose ne raste te tjera te vendosura nga gjithe ortaket....

Rasti tjetër që parashikohet në këto dispozite është që ka të bëjë me pushimin e veprimtarisë në mënyrë të detyrues nga shteti kur ushtron aktivitet të paligjshëm, nuk shtrohet për diskutim në këto gjykime, sepse nuk është ngritur një pretendim i tillë.

Pra, këto dispozite parashikon këto raste të pushimit të shoqerisë për shkak që nuk kanë të bëjnë me cenimin e rendit juridik:

- a) *plotesimin e afatit 30 vjecar,*
- b) *para afatit, për mungesë rentabiliteti ose në raste të tjera, me vendim të të gjithë ortakeve.*

Neni 38 i Statutit parashikon procedurat e likuidimit të shoqerisë në përputhje me nenin 264 e vijues të Ligjit *"Për shoqerite tregtare"*.

Sipas dispozites se mesiperme, (te titulluar *"Rregullat e likuidimit"*), *"Likuidimi i shoqerive rregullohet nepermjet dispozitave qe permbahen ne statut, duke mbajtur parasysh edhe dispozitat e ketij nenseksioni"*.

Nenet 37 e 38 te statutit parashikojne prishjen dhe likuidimin e shoqerise me vendim te Asamblese se ortakeve dhe nepermjet ushtrimit te kompetencave te organeve te tjera drejtuese te shoqerise.

Asnjë dispozite e statutit nuk parashikon juridiksionin gjyqësor për zgjidhjen e konflikteve lidhur me kërkesat apo pretendimet për prishjen dhe likuidimin e shoqerisë. Përkundrazi, sipas nenit 39 të statutit, *"Cdo konflikt që lind në"*

zbatim te statutit dhe kontrates se shoqerise do te zgjidhet perfundimisht ne Gjeneve (Zvicer), ne perputhje me Rregullat e Pajtimit dhe Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise, nga nje ose me shume arbitra te emeruar ne perputhje me keto Rregulla.

Ne se palet shprehimisht bien dakord dhe jo ndryshe, arbitrat do te veprojne si ndermjetes paqesore ne dhenijen e vendimit te tyre.

Vendimi i arbitrave eshte perfundimtar, i pa apelueshem dhe i detyrueshem".

Dispozita e mesiperme (neni 39 i statutit) eshte dispozite juridiksionale, e pranuar me marrveshje te paleve (ortakeve) ndersa neni 37 i statutit nuk eshte dispozite juridiksionale. Per rrjedhoje, arsyetimi i gjykates se shkalles se pare qe i ve perballe keto dy dispozita me karakter te ndryshem, duke i cilesuar njerin me karakter konkret dhe tjetren me karakter te pergjithshem duke i dhene perparesi dispozites "konkrete", nuk ka sens.

Ne juridiksionin e arbitrazhit te zgjedhur nga palet (ortaket) me marrveshje paraprake eshte zgjidhja e te gjitha konflikteve qe kane palet lidhur me derdhjen e kapitaleve, krijimin e shoqerise, funksionimin e saj, arsyet e paraqitura ne kerkimet per prishjen e saj, etj.

Vetem pasi te zgjidhen ne rruge arbitrazhi pretendimet e mesiperme, e te tjera si keto, lidhur me permbushjen ose jo te detyrimeve qe burojne nga akti i themelimit dhe statuti i shoqerise, mund te kalohet ne procedurat e prishjes e te likujdimit te shoqerise.

Edhe pretendimi tjeter i ngritur ne rekurs, sipas te cilit gjykata e apelit ka shkelur haptazi nenin 3 te ligjit nr.8017 date 25.10.1995 "Per procedurat e falimentimit", eshte i pabazuar.

Neni 3 i ketij ligji parashikon: "Gjykata kompetente per zhvillimin e procedurave te falimentimit eshte ajo ku debitori ka vendbanimin ose seline e tij".

Kjo dispozite qe parashikon se kush eshte gjykata kompetente per zhvillimin e nje procedure falimentimi, nuk ka lidhje me ceshtjen tone; ceshtja ne shqyrtim ka te beje me probleme juridiksionale.



Per me teper, ne nje veshtrim te pergjithshem, nuk kemi ne shqyrtim ndonje ceshtje falimentimi, te nisur sipas kerkesave te Ligjit "Per Procedurat e Falimentimit", te cilit i referohet rekursi.

PER KETO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykates se Larte, ne baze te nenit 59 dhe 485/d, te K.Pr.Civile,

VENDOSI:

Ndryshimin e vendimit nr.816, date 22.04.2003 te gjykates se apelit Tirane ne kete menyre:

- Prishjen e vendimit nr.4832, date 06.12.2002 te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane dhe pushimin e gjykimit te ceshtjes.

Tirane, me 10.07.2003

ANETAR
Nikoleta KITA

ANETAR
Valentina KONDILI

ANETAR
Agron A.LAMAJ

ANETAR
Irma BAJA

KRYESUES
Thimjo KONDI

L.Q.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE DHE U SHQIMIT *K.P.*
Drejtoria e Politikave Zhvillimore
dhe Privatizimit

Nr. 1182 Prot.

Tirane, me 26. 3. 1999.

LENDA : Per prishjen e kontrates se "S.Saranda" shpk

Zotit Vasil JATRU
5955 DELAFIELD AVE, RIVERDALLE

NEW YORK

U. S. A.

Sipas akteve te themelimit te "S. Saranda", shpk, Ju jeni ortak me 70 per qind te kuotave.

Kane kaluar 5 vjet nga krijimi i kesaj ndermarrje te perbashket por nga Ju, nuk jane zbatuar kushtet e kontrates, konkretisht :

- Nuk keni investuar.
- Ndermarrja e perbashket nuk ka funksionuar asnje dite si e tille.
- Nuk keni nxjerre licence ne zyren e Tatim-Taksave per ushtrim aktiviteti.
- E keni braktisur ndermarrjen e perbashket duke sjelle pasoje demtimin e pasurive te ortakut shteteror shqiptar.

Sa siper, brenda dates 30.04.1999, kerkojme konfirmimin tuaj per prishjen e kontrates se bashkepunimit, ne rast te kundert, kontrata konsiderohet e prishur dhe do te bejme ne menyre te njanshme veprimet e metejshme per c'rregjistrimin nga Regjistri Tregtar i Tiranes.

*Venteto lut
mjese me
originalen
Shefe Kabinetit
Adelina Rupa
Rupa*

MINISTRI

M. Xhuveli
Lufter XHUVELI



*Deri sot date 24.05.1999, q. Vazell Jahan
nuk me eshte pergjyftuar, c.ka riketom qyftuar
e l. spina llaci se ky investitor eshte pa odhese
dhe nuk mund te gjeendet.*

Fatos B. Mili